

FJALA E DEPUTETES ALBANA VOKSHI

E ENJTE 15 SHTATOR 2022

Së pari, dua ta nis me një problematikë, të cilën e kam hasur në mënyrë të vazhdueshme, por sidomos në këta muajt e fundit, që ka të bëjë edhe me atë që ne po flasim sot, pra me një standard europian, por edhe me një të drejtë kushtetuese, atë të funksionit të kontrollit parlamentar, pra e drejta e pushtetit legjislativ për t'u informuar dhe për të realizuar mbikëqyrjen për zbatimin e ligjeve nga institucionet. Pse po e përmend këtë? Sepse Kushtetuta e ka pajisur Kuvendin me mekanizma konkretë për realizimin e këtij kontrolli parlamentar nëpërmjet dëgjësave, interpelancave, por edhe nëpërmjet kërkesave për informacion që u dërgohen ministrive.

Unë kam këtu disa prej kërkesave që kam dërguar në disa ministri, por edhe agjenci dhe institucione varësie të ministrive, vetëm në dy muajt e fundit. I kam dërguar kërkesë për informacion Ministrisë së Shëndetësisë, Ministrisë së Drejtësisë, Ministrisë së Arsimit, agjencie të ndryshme dhe bashkisë së Tiranës. A e dini çfarë ka ndodhur? Nuk kthejnë fare përgjigje, thjesht refuzojnë në mënyrë arrogante. Për këtë kampione është zëvendëskryeministrja, Belinda Balluku, të cilës i kam kërkuar në mënyrë të përsëritur informacion për shembjet e banesave në Unazën e Re, në Laprakë, në Paskuqan, në lagjen "5 Maji" e kështu me radhë, por ajo refuzon të kthejë përgjigje.

Tjetri në radhë është ministri i Drejtësisë, i cili duhet të garantojë zbatimin e ligjit. I kam kërkuar një raport të Drejtorisë Antikorrupsion për sa i përket një auditimi që është bërë për arsimin parauniversitar. Në këtë raport rekomandohet që të merret masa e shkarkimit për 75 drejtues, specialistë sigurie, për një raport antikorrupsion, ku janë emrat e atyre që kanë shkatërruar arsimin parauniversitar? Jo, edhe këtu nuk po tregoni të vërtetën, sepse keni refuzuar dy herë të ktheni përgjigje. Herën e parë keni thënë "prisni se do të pyes ministren e Arsimit nëse e ka marrë parasysh raportin tim". Është qesharake kjo që bëni. Ju jeni ministër dhe duhet të garantoni zbatimin e ligjit, por refuzoni, duke shkelur në mënyrë konstante Kushtetutën.

I kam kërkuar ministres së Shëndetësisë informacion për Check up-in, informacion për koncesionin e sterilizimit, por refuzon të kthejë përgjigje, duke thënë se çështja është në SPAK. Çfarë lidhje ka hetimi i SPAK-ut me numrin e analizave të Check up-it dhe me numrin e instrumenteve të sterilizimit? Nuk ka asnjë lidhje, por duan të fshehin korrupsionin dhe babëzinë. I kam kërkuar ministres informacion në lidhje me sigurimin e ilaçeve për fëmijët e sëmurë me leucemi dhe tumor, bazuar kjo edhe në disa investigime. Për këtë çështje dua të përshëndes një prej gazetarëve që ka bërë investigime shumë të mira në këtë drejtim, Osman Stafën. Mendoni se ka dhënë informacion? Jo, nuk ka dhënë informacion as për këtë çështje.

Ka thënë vetëm “kemi siguruar fondin dhe procedurat”. Ama sot, prej më shumë se 4 vjetësh, fëmijët dhe prindërit e tyre vuajnë, sepse nuk gjejnë atë që duhet t’u sigurohej nga ministrja dhe Ministria e Shëndetësisë. Nuk japin asnjë informacion. Kështu do të vazhdoni, me mungesë transparence? Kjo është ajo që keni parasysh kur flisni për standardet europiane? Unë do të vazhdoj të kërkoj deri sa të marr informacionin. Ju siguroj se unë dhe kolegët e mi jemi këtu për të bërë transparencë dhe për të denoncuar korrupsionin, sidomos ju që keni abuzuar me paratë e shëndetit dhe të arsimit. Nuk do t’i gëzoni ato, kudo që t’i keni fshehur. Kush abuzon me paratë e taksapaguesve shqiptarë, do të shkojë para drejtësisë.

Për t’u kthyer te marrëveshja që po diskutojmë sot, nuk ka asnjë dyshim që Partia Demokratike do ta votojë pro atë, ashtu siç do të votojë pro çdo marrëveshjeje që ndihmon Shqipërinë. Nuk ka dyshim që edhe vota ime do të jetë pro kësaj marrëveshjeje, që synon të çojë përpara procesin e integritetit europian, të vonuar pikërisht prej asaj që unë përmenda më sipër. Për shkak të abuzimit të kësaj qeverie, për shkak të korrupsionit, për shkak të shkeljes së standardeve, të ligjeve dhe të Kushtetutës, sot jemi më larg Bashkimit Europian nga sa ishim 9 vjet më parë. Ajo për të cilën unë kam dyshime të mëdha, të cilat i shprehën edhe kolegët e mi, është që, siç kanë abuzuar me paratë dhe fondet e taksapaguesve shqiptarë, pra me fondet e buxhetit të shtetit, do të abuzojnë edhe me paratë e IPA-s, sepse kësaj qeverie nuk i interesojnë standardet, por vetëm fondet.

Për të gjithë ata që na ndjekin, fondet e IPA-s janë paratë e taksapaguesve europianë, që Bashkimi Europian jep për vendet që duan të anëtarësohen në Bashkimin Europian. Shumë

kemi marrë. Prej vitit 2007 ka pasur disa marrëveshje të asistencës për fondet IPA dhe kjo është e treta. Çfarë është bërë në këta 9 vjet? Shqipëria nuk ka avancuar në asnjë drejtim. Reforma në drejtësi ka dështuar, shteti i së drejtës nuk ekziston, ligji është i pabarabartë, qytetarët shqiptarë nuk marrin drejtësi. 5 vjet pas miratimit në këtë Kuvend të Reformës në Drejtësi shqiptarët nuk kanë drejtësi.

Zgjedhjet e lira dhe të ndershme janë zhdukur si nocion me Edi Ramën në krye. Çdo votues sot është vulnerabël përballë sistemit monstruoz të patronazhimit. Me leje dhe me porosi të Edi Ramës vjedhja e të dhënave personale është vënë në dispozicion, është përpunuar nga AKSHI dhe ato u janë dhënë të gjitha zyrave elektorale të Partisë Socialiste edhe në zgjedhjet e fundit. Ky është një krim elektoral i pandëshkuar, sepse në Shqipëri nuk ka drejtësi. Në shkelje flagrante të ligjit “Për mbrojtjen dhe përdorimin e të dhënave personale”, në cenim të rëndë të së drejtës kushtetuese për privatësi apo të standardeve të Bashkimit Europian, i cili e ka shumë të rëndësishme mbrojtjen e të dhënave personale, Rama ngriti dhe po e perfeksionon më tej modelin e patronazhistit.

Patronazhisti është simboli tipik i shkeljes së lirisë dhe të drejtës së zgjedhësve për të votuar të lirë, ndaj asistenca e BE-së nevojitet për të shkatërruar këtë sistem monstruoz patronazhimi dhe për të krijuar kushtet e duhura që të gjithë qytetarët shqiptarë të votojnë lirshëm. Për sa i përket krimit të organizuar, askush nuk i harron imazhet e fushave dhe maleve të blerta me kanabis, që ende lulëzojnë. Raportet e organizatave të specializuara ndërkombëtare theksojnë faktin se Shqipëria në 7 vjetët e implementimit të strategjisë për luftën ndaj krimit të organizuar ka dështuar në të gjithë indikatorët dhe qeveria, jo vetëm që nuk e ka luftuar, por është bërë aleatja më e mirë e krimit të organizuar dhe bashkëqeveris me të. Nëse flasim për krimin e organizuar, ai është i lidhur me korrupsionin.

Shqipëria zë vendin e parë në Europë dhe në rajon për sa i përket nivelit të lartë të korrupsionit. Është në vendin e 110-të, duke rënë 6 vende këtë vit, sipas Transparency International. Sa më shumë rritet korrupsioni, aq më shumë shkelen të drejtat e qytetarëve. Shikoni me sa arrogancë Edi Rama vë përballë zyrtarëve të Bashkimit Europian atë që është simboli i korrupsionit, simboli i vjedhjes, koordinatori Ilir Beqaj. Çfarë presim ne nga Ilir Beqaj? A e di

delegacioni i Bashkimit Europian kush është Ilir Beqaj? Të pyesin në SPAK sa çështje ka Ilir Beqaj për vjedhje, korrupsion dhe abuzim me postin. Si përdoren fondet? Marrim rastin e shkollave, që e përmendi edhe zoti Berisha.

Një shkollë me standarde europiane, e ndërtuar me fondet të Bashkimit Europian dhe e implementuar nga PNUD-i, kushton 680 mijë euro maksimumi, kurse me standardet e Erion Veliajt një shkollë kushton 4,7 milionë euro pa TVSH dhe 6 milionë euro me TVSH. Po ashtu, mund të përmend edhe rrugët e arta të qeverisë “Rama”. Rruga Vlorë-Orikum, e ndërtuar me huan e marr nga BERZH-it, kushtoi 600 mijë, kurse vetëm 1 kilometër i rrugës Orikum-Dukat kushtoi 5 milionë euro.

Pra, fondet IPA nevojiten dhe të gjithë ne do të votojmë pro kësaj marrëveshjeje, por ne kërkojmë një monitorim shumë të afërt dhe të detajuar të çdo procedure për tenderimin dhe implementimin e tyre, në mënyrë që ato të mos shkojnë atje ku kanë shkuar edhe fondet e buxhetit të shtetit. Faleminderit!